

Faktorët e Rritjes Ekonomike në Shqipëri

në fokusin e presioneve të krizës
ekonomike globale

Gjergji Filipi

Tirana Economic Forum
March 10, 2009



Performanca ekonomike e Shqipërisë


Në 10 vjecarin e fundit, rritja mesatare vjetore e PBB-së ka qënë rreth 7 %.

Që prej vitit 1993 fillon tendenca pozitive me ritme relativisht të larta (10 përqind për atë vit).

Viti 1997 shënon një ndërprerje bruske të rritjes, prodhimi i brendshëm zvogëlohet me 7 pikë përqindjeje.



Rritja reale e PBB-së për Shqipërinë dhe për vendet e Evropës Juglindore, 1998-2008.




Burimi: BERZH, Transition Report

Tirana Economic Forum
March 10, 2009

Prekja e grupvendeve nga kriza globale

Ritmet e rritjes së PBB (në përqind)



Burimi: FMN, Janar 2009

Tirana Economic Forum
March 10, 2009

Performanca ekonomike e Shqipërisë

Pavarësisht rritmeve optimiste, ekonomia Shqiptare ka shumë për të bërë në mënyrë që t'i afrohet niveleve të mirëqënies në ekonomitë fqinje.

Vendi mbetet një ndër më të varfrit në Evropë.

Për shkak se ekonomia shqiptare e ka nisur tranzicionin nga një nivel ekstremisht të ulët, prodhimi i saj kombëtar duhet të rritet me **ritme më të larta** në mënyrë që të kapë (catch up) standartet e ekonomive fqinje.

Renditja sipas PBB për frymë (EU27=100)

Luksembourgu	276	Gjermania	113	Sllovakia	69
Norvegjia	184	Franca	111	Hungaria	63
Irlanda	146	Spanja	107	Lituania	60
Zvicra	137	Italia	101	Letonia	58
Hollanda	131	Greqia	98	Kroacia	55
Austria	128	Qiproja	93	Polonia	54
Suedia	126	Slovenia	89	Turqia	42
Danimarka	123	Republika Çeke	82	Rumania	41
Belgjika	118	Malta	77	Bullgaria	38
Finlanda	116	Portugalia	75	Serbia	35
Mbretëria e Bashkuar	116	Estonia	72	Maqedonia	29
				Shqipëria	22


Cilat janë shtysat?

Identifikojmë tre burime të ndryshme nxitjeje:

- Stabiliteti makroekonomik
- Faktoret e produktivitetit, dhe
- Zgjerimi i konsumit



Politikat makro



Stabiliteti makroekonomik ka inkurajuar mjedis ekonomik të favorshëm, çmime relativisht të qëndrueshme, dhe nivel të kënaqshëm besimi ndaj monedhës.

Konsolidimi i Financave Publike

- Reduktimi i deficitit buxhetor nga rreth **12%** të PBB-së që ishte në vitin 1998, në **3,4%** në 2007-ën.
- Zvogëlimi i borxhit të përgjithshëm publik nga **75%** e PBB-së që ishte në vitin 1998, në **51,4%** në vitin 2007.

Të dhënat nga: EBRD, Transition Report 2008

Faktorët e produktivitetit

Rialokimi i burimeve nga sektorët me produktivitet të ulët drejt atyre me produktivitet më të lartë, nxiti ritme të larta rritjeje me nivel modest investimesh.

Produktiviteti i Tërësisë së Faktorëve (TFP) shpjegon pothuajse të gjithë rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke përbërë mbi 80 % të rritjes së PBB- së gjatë gjithë periudhës së tranzicionit.



Zgjerimi i konsumit


Ka dy elemente bazë që nxisin këtë ekspansion:

1. Rritja e kreditimit
2. Remitancat e emigrantëve

Sa i përket ritmeve të kreditimit, ekonomia shqiptare nuk ofron ndonjë tendencë specifike të veçantë.



Niveli i kreditimit, ndryshimi ndaj vitit paraardhës (në përqind)




Burimi: BERZH, Transition Report

Tirana Economic Forum
March 10, 2009

Niveli i kreditimit. Ndikimi i krizës?

Ritmi mujor i rritjes së kreditimit



Burimi: Banka e Shqiperise

Remitancat

Remitancat janë burimi më i madh i prurjeve valutore në vend.

Për disa vite rradhazi, sasia e tyre kapërceu edhe kombiminin e vlerave të eksporteve dhe të FDI-ve të marra së bashku.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Remitancat në milion USD	368	531	615	632	778	1,028	1,161
Remitancat ndaj PBB (%)	11	14	15	14	13	14	14
Remitancat ndaj Deficitit Tregtar (%)	56	65	60	55	58	65	64

Remitancat. Ndikimi i krizës?

Shifrat më të fundit të bëra publike nga Banka e Shqipërisë i takojnë 9-mujorit të parë të vitit 2008.

- Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007, këto transferta vlerësohen 13% më të ulëta.
- Ato kapin vlerën e 623 mln EUR dhe mbulojnë vetëm rreth 37% të deficitit tregtar.

FMN parashikon nivelin e **11,5%** të PBB për 2008 dhe vetëm **9,1%** për 2009.

Ç'mund të bëhet

Rënia e ritmeve të kreditimit duhet adresuar saktë dhe shpejtë, duke hartuar mekanizma nxitës për stimulimin e kreditimit si “karburanti” i domosdoshëm për përballimin e presioneve frenuese mbi ekonominë.

Rënia e dërgesave nga emigrantët duhet kompensuar duke mbështetur:

- Eksportet për riekulibrimin e prurjeve valutore
- Shtresat që ndikohen drejtpërsëdrejti në konsum nga kjo rënie

Ç'mund të bëhet

Duhet siguruar funksionimi sa më eficient i konkurrencës së lirë, duke lejuar të aktivizohen mekanizmat e stabilizimit automatik të tregjeve.

Duhet ndaluar praktikat fiskale të tipit “a forfait”, të cilat në kushte krize krijojnë presione të panevojshme mbi operatorët ekonomikë.

